



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE

Tiranë më

protdate

Nr.

protnumber

RELACION
PËR
VENDIMIN
PËR
**CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARËT DHE
SEKRETARIN E KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR
NR. 88, PËR ZGJEDHJET E PJESSHMEPËR KRYETAR TË BASHKISË
HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN
NË FUQI**

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 244, datë 5.7.2024, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë”, ka vënë në lëvizje Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar në Bashkinë Himarë.

Referuar nenit 19, shkronja “ç”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 7, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, miratuar me vendimin e Komisionit Rregullator, nr. 5, datë 20.11.2020, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve emëron anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve.

Referuar nenit 19, pika 1, shkronja “n”, të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen atij me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Referuar neneve 20 dhe 21, të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në mënyrë shteruese nuk përcaktohet kompetenca për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarë të KZAZ-ve.



II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Kodi Zgjedhor, neni 29, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, përcakton se anëtarët e KZAZ-së, emërohen nga KQZ, sipas kësaj procedure:

- dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e shumicës parlamentare, dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e opozitës parlamentare, një anëtar propozohet nga partia e dytë e shumicës parlamentare dhe një anëtar propozohet nga partia e dytë e opozitës parlamentare.

- Në rast se nuk arrihet baraspeshimi politik, grupi përkatës kompensohet me kandidaturat e partisë kryesore deri në baraspeshimin politik shumicë-opozitë.

-Anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare.

Bazuar në përcaktimet e nenit 29, pika 4, të Kodit Zgjedhor, në zgjedhjet vendore, renditja përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet pararendëse nga partitë parlamentare.

Bazuar në vendimin nr. 27, datë 7.8.2023, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, bazuar në rezultatin e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë, subjektet zgjedhore janë renditur si vijon:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)	579.625	43,11%
2. Bashkë Fitojmë (BF)	247.883	18,44%
3. Partia Demokratike (PDSH)	103.723	7,71%
4. Partia Socialdemokrate (PSD)	86.283	6,42%

Referuar shkresës së Kuvendit të Shqipërisë nr. 259/1 prot., datë 24.1.2022, partitë parlamentare janë si vijon:

Shumica parlamentare

1. Partia Socialiste e Shqipërisë:
74 mandate në Kuvendin e Shqipërisë

Pakica parlamentare

1. Partia Demokratike e Shqipërisë “Aleanca për Ndryshim”:
59 mandate në Kuvendin e Shqipërisë
2. Lëvizja Socialiste për Integrim:
4 mandate në Kuvendin e Shqipërisë
3. Partia Socialdemokrate:
3 mandate në Kuvendin e Shqipërisë

Në analizë të dispozitave të Kodit Zgjedhor, rezultati përfundimtar i zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, dhe të shkresës së Kuvendit të Shqipërisë nr. 259/1 prot., datë 24.1.2022, arsyetohet si vijon:

- Neni 29, pika 4, fjalia e dytë, i Kodit Zgjedhor, përcakton qartë procedurën që ndiqet për caktimin e partive që kanë të drejtë të propozojnë anëtarët e KZAZ-ve. Në zgjedhjet vendore, renditja përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet pararendëse nga partitë parlamentare

Që një parti të gëzojë të drejtën për të propozuar kandidatë për KZAZ, duhet të plotësojë 2 kushte, së pari të ketë marrë pjesë në zgjedhjet pararendëse për organet e pushtetit vendor dhe së dyti, të jetë parti parlamentare.

- Dy anëtarë të KZAZ-së i propozon partia kryesore e shumicës parlamentare, e cila ka marrë numrin më të madh të votave në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, brenda konfigurimit të shumicës parlamentare sipas rezultatit të zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021. Një anëtar të KZAZ-së e propozon partia e dytë e shumicës parlamentare, e cila ka marrë numrin më të madh të votave në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, pas partisë kryesore të shumicës.

- Dy anëtarë të KZAZ-së i propozon partia kryesore e opozitës parlamentare, e cila ka marrë numrin më të madh të votave në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, brenda konfigurimit të pakicës parlamentare, sipas rezultatit të zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021. Një anëtar të KZAZ-së e propozon partia e dytë e pakicës parlamentare, e cila ka marrë numrin më të madh të votave në shkallë vendi, për këshillat vendorë, në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, pas partisë kryesore të pakicës.

- Kodi përcakton se anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse gjysma tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare. Në zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Himare, anëtari i shtatë do të përcaktohet me short ndërmjet partisë së parë të shumicës parlamentare dhe partisë së parë të opozitës parlamentare.

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 722, datë 19.08.2023 “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor Nr. 11, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023” arsyetoi se në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, subjekti zgjedhor, koalicioni “Bashkë Fitojmë”, bazuar në dokumentacionin e kandidimit ka deklaruar “Partinë e Lirisë”, si parti udhëheqëse të koalicionit. Në bazë dhe për zbatim të nenit 65, të Kodit Zgjedhor, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit.

- Për efekt të zbatimit të procedurës për përbërjen e KZAZ-së nr. 11 për zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Kukës, u përcaktua që “Partia Socialiste e Shqipërisë”, të propozojë tre kandidatura për anëtarë të KZAZ-ve, dy kandidatura si parti e parë e shumicës parlamentare dhe kandidatura e tretë për të realizuar baraspeshimin politik shumicë-opozitë në përbërjen e KZAZ-së.

- Partia e parë e opozitës parlamentare, e cila do të propozojë dy anëtarë të KZAZ-së, është “Partia e Lirisë” dhe partia e dytë e opozitës parlamentare, e cila do të propozojë një anëtar të KZAZ-se, është “Partia Demokratike” (PDSH).

- Ky vendim u ankimua nga subjekti Partia Demokratike në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve e cila la në fuqi vendimmarrjen e Komisionerit dhe më pas u ankimua në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor.

- Kolegji Zgjedhor Gjyqësor me vendimin nr. 35 date 15.9.2023, ka shqyrtuar vendimin nr. 181 date 7.9.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në KQZ (KAS).

- Kolegji vlerëson se: gjatë gjykimit ka rezultuar se, vetë KQZ konkretisht Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ka kryer hetim administrativ për të përcaktuar numrin e votave që ka fituar në shkallë vendi “Partia e Lirisë” në zgjedhjet vendore të datës 14.05.2023 si pjesë e koalicionit “Bashkë fitojmë”, në kushtet kur në listën shumëemërore të kandidatëve për këshilltarë të këtij koalicioni nuk ka të shënuar përbri emrit të kandidatit edhe siglën e partisë pjesë të koalicionit që i përket kandidati. Nga ky hetim administrativ KAS-it i ka rezultuar se “Partia e Lirisë” ka fituar 113 mandate për këshilltar në shkallë vendi në zgjedhjet e fundit vendore të datës 14.05.2023.

- Për të përcaktuar numrin e votave që ka fituar në shkallë vendi “Partia e Lirisë” në zgjedhjet vendore të datës 14.05.2023 si pjesë e koalicionit “Bashkë fitojmë”, për efekt të zbatimit të nenit 29 të Kodit Zgjedhor, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor çmon se, si Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ashtu edhe KAS duhet të kishin përcaktuar fillimisht mesataren e votave në shkallë vendi për mandat të fituar nga ana e koalicionit “Bashkë Fitojmë” në zgjedhjet e fundit vendore të datës 14.05.2023. Duke e shumëzuar këtë mesatare me numrin e mandateve që ka fituar “Partia e Lirisë” në zgjedhjet e fundit vendore të datës 14.05.2023, rezultati përfaqëson numrin e votave që ka fituar në shkallë vendi për zgjedhjet vendore të datës 14.05.2023 “Partia e Lirisë”. Në këtë mënyrë mund të përcaktohej në rrethanat konkrete se, cila është partia kryesore e opozitës parlamentare dhe partia e dytë e opozitës parlamentare, që kanë të drejtën të propozojnë anëtarët e KZAZ-së për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 24.09.2023.

- Këtë konkluzion Kolegji Zgjedhor Gjyqësor e bazon në interpretimin me analogji të nenit 88/3 të K.Zgjedhor, me qëllim zgjidhjen e kësaj çështje, (në kushtet kur nuk ka mënyrë tjetër ligjore), se cila është partia kryesore e opozitës parlamentare dhe partia e dytë e opozitës parlamentare, që kanë të drejtën të propozojnë anëtarët e KZAZ-së për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 24.09.2023.

- Si neni 29 ashtu edhe neni 88/3 i Kodit Zgjedhor parashikojnë të drejta që iu takojnë partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e fundit. Të drejtat që parashikohen për partitë politike në të dy këto dispozita ligjore kushtëzohen me numrin e votave të vlefshme të marra prej tyre në shkallë vendi.

- Koalicioni “Bashkë fitojmë” ka marrë 247,883 vota të vlefshme në shkallë vendi në zgjedhjet e fundit vendore të datës 14.05.2023 dhe 292 mandate këshilltarësh në këshillat bashkiakë. Numri i votave të vlefshme në shkallë vendi e koalicionit “Bashkë Fitojmë” prej 247,883 vota i pjesëtuar me numrin e mandateve të fituara prej 292 jep numrin 849. Numri 849 paraqet numrin mesatar i votave të vlefshme për mandat të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Nëse shumëzohet numri mesatar i votave të vlefshme për mandat të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” prej 849 me numrin e mandateve të fituara nga “Partia e Lirisë” prej 113 mandatesh, rezultati është 95,937 (nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë). Ky numër paraqet votat që ka marrë në total në shkallë vendi Partia e Lirisë në zgjedhjet vendore të datës 14.05.2023. Ky numër prej 95,937 votash është më i vogël se numri 103,723 votash që ka fituar subjekti “Partia Demokratike e Shqipërisë” në zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

- Në të tilla rrethana Kolegji Zgjedhor Gjyqësor arriti në përfundimin se, partia kryesore e opozitës parlamentare është “Partia Demokratike e Shqipërisë” (PDSH), ndërsa partia e dytë e opozitës parlamentare është “Partia e Lirisë” (PL).

Për sa më lart, renditja e partive për efekt të zbatimit të procedurës për përbërjen e KZAZ-së nr. 88 për zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Himarë, është si më poshtë:

- “Partia Socialiste e Shqipërisë”, do të propozojë tre kandidatura për anëtarë të KZAZ-ve, dy kandidatura si parti e parë e shumicës parlamentare dhe kandidatura e tretë për të realizuar baraspeshimin politik shumicë-opozitë në përbërjen e KZAZ-së.

- Partia e parë e opozitës parlamentare, të cilat do të propozojë dy anëtarë të KZAZ-së, është “Partia Demokratike” PDSH dhe partia e dytë e opozitës parlamentare, e cila do të propozojë një anëtar të KZAZ-se, është “Partia e Lirise” (PL).

Në përfundim të shortit ndërmjet “Partisë Socialiste të Shqipërisë” dhe “Partisë Demokratike” për përcaktimin e anëtarit të shtatë, do të përcaktohet dhe partia, e cila ka të drejtë të propozojë sekretarin e KZAZ-së nr. 88.

Shorti do të ndjekë hapat e përcaktuar në nenin 4, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”.

Duke qenë se zgjedhjet e datës 4 gusht 2024, zhvillohen vetëm në KZAZ-në nr. 88, Bashkia Himarë, partisë politike, përfaqësuesi i së cilës tërheq gogllën në enën e dytë me përcaktimin në shirit “Cift” ka të drejtë të propozojë anëtarin e shtatë në KZAZ-në nr. 88.

Në bazë të nenit 29, pika 2, të Kodit Zgjedhor, në përfundim të shortit, anëtari i shtatë i KZAZ-së nr. 88 do të propozohet nga “Partia _____”, ndërsa sekretari do të propozohet nga “Partia _____”.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

(Në mungesë dhe me urdhër)

Majlinda ÇELMETA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

V E N D I M
P Ë R

**CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARËT DHE
SEKRETARIN E KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR
NR. 88, PËR ZGJEDHJET E PJESSHMEPËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË,
TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 244, datë 05.07.2024, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë”, të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 29, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

- Partitë politike që do të propozojnë anëtarët e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) nr. 88, që do të ngrihet dhe funksionojë për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarine Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024, janë si më poshtë:
 - Tre anëtarë propozohen nga “Partia Socialiste e Shqipërisë” (PSSH);
 - Dy anëtarë propozohen nga “Partia Demokratike” (PDSH);
 - Një anëtar propozohet nga “Partia e Lirise” (PL).
- Anëtari i shtatë i KZAZ-së nr. 88 do të propozohet nga “Partia _____”.
- Sekretari i KZAZ-së nr. 88 do të propozohet nga “Partia _____”.
- Partitë politike duhet të paraqesin kandidaturat për anëtarë dhe sekretar të KZAZ-së në KQZ.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: dd mm vvvv Nr:
Ora: hh:mm



“Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 88, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”